



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2021:165747

Datë: 25.11.2024

Numri i dokumentit: 06499825

C.nr.617/2021

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI, gjyqtari Alush Sinani, me bashkëpuntorën profesionale Lumturije Fetahu Xhelili, në çështjen kontestimore të paditësit B.S., nga fshati M., Komuna e S., të cilën me autorizim i përfaqëson T.I, avokat në Prishtinë, Rr. “Selim Kraja”, nr.3-Hajvali, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “ILLYRIA” sh.a., me seli në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë”, nr.33, me objekt të kontestit kompensim i dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 4,900.00 Euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor më datë 18.11.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Miratohet pjesërisht si e bazuar me ligj, kërkesëpadia e paditësit B.S., detyrohet e paditura, Kompania e Sigurimeve “ILLYRIA”, që paditësit, për shkak të aksidentit të datës 01.09.2020, t’ia shpërblej dëmin material dhe jomaterial në këtë mënyrë:

Në emër të kompenzimit të dëmit jo material:

- për të gjitha llojet e dhimbjeve fizike shumë prej prej 900.00 € euro, (nëntëqindë euro).
- Për të gjitha llojet e frikës, në shumë prej 800.00 € euro (tetëqindë euro).

Shumen e kompenzimit të dëmit jo material prej 1,700.00 € euro (një mijë e shtatëqindë euro).

Në emër të dëmit material:

- për të gjitha format e ushqimit të përforcuar për 10 ditë humën prej 100.00 € euro (njëqindë euro),

Shumen e kompenzimit të dëmit material prej 100.00€ euro, (njëqindë euro)

Gjithsej shumen e përgjithëshme për kompenzimin e dëmit material dhe jo material prej 1,800.00 (njëmijë e tetëqindë) euro.

II. Obligohet e paditura që në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë të aktgjykimit, ti kompenzon paditësit si në pikën I. të njëjtit aktgjykim, me kamatë ligjore në larësi prej 8 % në vit, për dëmin material duke filluar nga data 27.07.2021 (data kur është dorëzuar padia në gjykatë) ndërsa për dëmin jo material nga data 21.11.2024, datë kur është vendosur me këtë aktgjykim, nën kërcënim me përmbarrim me dhunë.

III. Refuzohet pjesa e kërkesëpadiës së paditësit, e kërkuar përtej shumës së miratuar në pikën I, -për të gjitha format dhimbjeve fizike shumen prej 1,100.00 € euro, për të gjitha format e frikës, shumë prej 1,200.00 € euro, për të gjitha format e kujdesit dhe ndihmes huaj shumë prej 300.00 € euro, për të gjitha format e ushqimit të përforcuar shumë prej 300.00 € euro, gjithsej për dëmin material dhe jo material shumen prej 2,800.00 € euro (dymijë e tetëqindë euro).

IV. Obligohet e paditura që paditësit t'iu kompensoj shpenzimet e procedurës në total, në shumë prej 715 euro (shtatëqind e pesëmbëdhjet) dhe ate; për përpilimin e padisë shumen 104 euro, për pagimin e takses gjyqesore shumen prej 41 euro, për përfaqësim të avokatit në dy seanca gjyqesore të mbajtura ku shuma e një seance është 135euro në total është shuma 270 euro, për shpërblimin e ekspertëve për dy ekspertiza mjekësore, shumen prej 300 € euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Arsyetim

Rrjedha e procedurës

Paditësi B.S. nga fshati M., Komuna e S., të cilin me autorizim i përfaqëson, av. T.I, avokat në Prishtinë, ka paraqitur padi në gjykatë më datë 27.07.2021, kundër të paditurës kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 01.09.2020. në Rr. „e Preshevës”, ku lëndime të lehta trupore kishte pësuar paditësi, B.S., dhe për shkak të këtyre lëndimeve ka kërkuar ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit të përgjithshëm rajonal në Viti. Nga këto lëndime paditësi kishin përjetuar dhembje fizike, frikë, kanë pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë, kanë pasur nevojë për ushqim të përforcuar, kanë pasur nevojë për rehabilitim klimatik si dhe kanë bërë shpenzime materiale për shërim, andaj për këto forma kanë kërkuar që t'u kompensohet dëmi.

Gjykata, pas pranimit të padisë, duke vepruar konform nenit 394 , të LPK- së, palës së paditur i ka dërguar një kopje të aktvendimit për përgjigje në padi, në mënyrë që e njëjta të përgjigjet lidhur me pretendimet e saja.

E paditura në përgjigje në padi, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, po e ka kundërshtuar për nga lartësia e saj, duke theksuar se kërkesëpadia e paditësit është shumë e lartë dhe nuk është në përputhje me shkallen dhe natyrën e lëndimeve, te cilat paditësi i ka pësuar në këtë aksident të komunikacionit rrugor.

Gjykata, në lidhje me këtë çështje më dt. 17.09.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancen përgaditore.

Pretendimet e palëve në procedure

Përfaqësuesi i paditësit avokati T.I. në seancën përgaditore të datës 17.09.2024, ka deklaruar; mbetë në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, dhe ka propozuar nxerrjen e provës përmes ekspertëve nga lëmia e ortopedisë ku për ekspertë ka propozuar A.F., ortopedet traumatog si dhe nxerrjes e ekspertizës së psikiatrisë dhe ku për eksperte propozoi Valbona Tafilaj.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës, në seancen përgaditore të datës 17.09.2024 edhe pse e ka pranuar ftesën për këtë seancë nuk ka preznetuar.

Përfaqësuesi i paditësit avokati T.I., në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.11.2024, ka deklaruar se; fillimisht ka konfirmuar se ka pranuar ekspertizën mjeko-ligjore për të cilën nuk ka pasur vërejtje apo komente. Në këtë fazë të procedurës pas pranimit të ekspertizës nga ekspertët mjeko-ligjor, ortopedise dhe psikiatrisë, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe ate në emër të të gjitha dhimbjeve fizike, ka kërkuar shumën prej 2000 euro, në emër të përjetimit të frikës shumen prej 2000 euro, në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të huaj shumën 300 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën 300 euro, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material shumen e përgjithshme prej 4600 euro të gjitha këto me kamate prej 8% konform LMD-së edhe ate nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare. Gjykates i ka propozuar që si prova të administron:

procesverbalin e policisë me numër të rastit 2020-CR-398 Të datës 01.09.2020 se bashku me skicen e vendit të ngjarjes, raporti mjekësor nga Qendra Emergjente e shëndetit në Viti me numër 1/806 i datës 01.09.2020, ekspertizat mjeko-ligjore nga lemia e ortopedise dhe psikiatrisë e dates 24.10.2024. Edhe në fjalën përfundimtare, përfaqesuesi i paditesit avokati T.I. ka deklaruar se mbetet në tëresi prane padise dhe kerkespadise si dhe precizimit të padise ,i ka propozua gjykates qe të njëjten ta aprovoj në teresi si të bazuar sepse nga provat e administruara u vërtetua se baza juridike si dhe lartësia, gjithashtu i kerkojn shpenzimet e procedures dhe ate për perpilimin e padise 104 euro, për precizimin e padisë me shkrim shumen prej 104 euro, për takse gjyqesore 41 euro, per dy seanca te mbajtura secila nga 135 euro gjithsej në shumen 270 euro si dhe shpenzimet per ekspertizen mjeko-ligjore shumen prej 300 euro, ne shume te pergjithshme 820.15 euro.

Perfaqesuesi me autorizim i të paditures, A.B.në gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 18.11.2024, ka deklaruar: për të padituren nuk është konstuese baza juridike e kerkesëpadisë por lartësia e saj, me kohe kan pranuar ekspertizen mjekësore nga lemia e ortopedise dhe psikiatrise dhe ndaj të njejes nuk kan verejtje dhe as pyetje per ekspertet që e kan punuar këtë ekspertize, sa i perket precizimit të kerkesëpadisë të njëjten e konstestoj për shkak të shumave të larta të kerkuara të cilat nuk jane np harmoni me natyren e lendimeve të pesuara.

Edhe në fjalën përfundimtare, përfaqesuesi me autorizim i të paditures, ka deklaruar se me rastin e vendosjes në këtë qeshtje juridike kontestimore i propozon gjykatës që të mos ti fal besimin precizimit të kerkesëpadise pasi që shumat e kerkuara për format e demit jo material janë shumë të larta dhe jo në propocion me natyre e lendimve trupore të pesuara e të vertetuara me ekspertiza mjekësore si lendime të lehta trupore, ndersa format e demit material të cilat nuk jane te vertetuar me fatura dhe kupona fiskal ti refuzoj ne tersi si te pabazuara. Sa i perket kamates ligjore kerkon nga gjykata qe e njeta te llogaritet apo te filloj të rrjedhë nga dita e marrjes se aktgjykimit, konform mendimit juridik të gjykates Supreme per kamat ligjore. Sa i perket shpenzimeve të procedures i propozojme gjykatës që ta refuzoj kerkesën per precizim e padise me arsyetimin se ne petitum të kerkesëpadisë shuma e kerkuar kaqenë 4,900 ndersa në precizim shuma e kerkuar është 4,600 euro dhe rastin konkret skemi të bejme me zmadhim e kerkesës së padise apo kerkesa per forma te reja te demit, mirpo te njejtat si per nga shuma ashtu edhe per nga format e demit janë zvoglua.

Provat e administruara

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje civilo-juridike, gjykata në seancën e dt.18.11.2024, bëri administrimin e këtyre provave edhe atë: procesverbalin e policisë me numër të rastit 2020-CR-398 Të datës 01.09.2020 se bashku me skicen e vendit të ngjarjes, raporti mjekësor nga Qendra Emergjente e shëndetit në Viti me numër 1/806 i datës 01.09.2020, ekspertizat mjeko-ligjore nga lemia e ortopedise dhe psikiatrisë e dates 24.10.2024.

Sa i përket provave të tjera materiale përaktësisht raporteve mjekësore gjykata i ka administruar, por nuk i ka elaboruar për shkak se e paditura nuk i ka kundërshtuar faktet të cilat vërtetohen me ato prova, nga se të njejtat jan konsumuar tek ekspertizat mjekësore.

Gjendja faktike e konstatuar;

Gjykata, përkatësisht gjyqtari i çështjes pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8, të LPK- së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, vërtetoi këtë gjendje faktike:

-Me leximin e procesverbalit (raportit) policor për aksidentin, nr.2020-CR-398, se bashku me skicen e vendit të ngjarjes: vërtetohet se me 01.09.2020 në ora 14:50 minuta, në rrugor e Preshevës , dysohet se akisidenti i komunikacionit të ketë ardhur atëhere kur të tri njësitë që ishin duke lëvizur në të njëjtin drejtim Kllokot-Viti, me të arritur tek kryqëzimi të Shtëpia e Shëndeti, njësa A (vetura e grabitu) ,

duke bërë vozitje të rrezikshme, duke mos përshtatur shpjgjetësin e lëvizjes automjetit , kushteve dhe gjendjes së rrugës zonë urbane si dhe duke bërë tejkalime të parregullta nga ana e djathtë fërkohet në krahu e parë të djathtë me njësin B, pastaj me krahu e partë të majtë e godet në krahu e parë djathtë njësin C, e cila ishte në ndjekje e sipër të automjetit të grabitur dhe në momentin kritik ja kishte ngushtuar këndin e lëvizjes duke i dal përpara me krahu e partë të djathtë pa fajin e tij paditësi , ka pësuar dëme materiale dhe lëndime trupore, si rezultat i këtyre lëndimeve paditës ka pësuar gjitha format e dhimbjeve fizike dhe frikës, ka pasur nevojë për ndihmën mjekësore, ndihmen e personit të tretë varësisht nga lëndimi, ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, fakte këto të cilat sipas nen.173 dhe 183 të LMD-së paraqesin bazë për kompensimin e dëmit, ky fakt, në mes palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues.

-Me leximin e ekspertizës mjekësore të ekspertit ortoped-traumatolog dr. A.F., e datës 24.09.2024, konstatoi se: Paditësi B.S., si pasojë e aksidentit të komunikacionit, kishte pësuar lëndime trupore duke i karakterizuar si lëndim të lehta trupore, dhe atë; Contusio art.R/C et mani dex, Contusio regio colli, dhe Vulnus excoriationem art.T/C et mani dex të pësuar në aksidentit të cilat kualifikohen si lëndime të lehta trupore, e të cilat kanë shkaktuar; dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë, 30 minuta, dhimbje të intensitetit të lartë, 48 orë, dhimbje të intensitetit të mesëm, 10 ditë, si dhe dhimbje të intensitetit të ulët, të cilat ekzistojnë edhe sot, poashtu paditësi nuk kishte nevojë për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë, ushqim i përforcuar për 10 ditë (ushqim i pasuruar me proteina, minerale dhe vitamina, kabohidrate) dhe pas këtij aksidenti, ndërsa për terapi dhe rehabilitim nuk ka apsur nevojë.

Këto fakte lidhur me natyrën dhe shkallen e lëndimeve të paditësit, gjykata i vërtetoi nga mendimi i ekspertit mjekësor Dr. A.F. – ortoped-traumatolog ,përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse nuk kishin vërejtje në mendimet dhe konstatimet e ekspertit në fjalë , gjykata mendimit të ekspertit në fjalë, ia fali besimin e plotë, për faktin se ekspertiza ishte e qartë, rreth natyrës dhe shkallës së lëndimeve, gjithashtu ishte e punuar në mënyrë profesionale, duke përdorur metodat e parapara për vlerësimin e dëmit, andaj gjykata vendosi që të caktoj shumat si në dipozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se është në proporcion real me natyrën dhe shkallen e lëndimeve të paditësit.

-Me leximin e ekspertizës mjekësore të ekspertes së psikiatrisë dr.V.T.psikiatre, të datës 24.10.2024, konstatoi se; Paditësi, B.S., në këtë aksident, në ditën kritike ka pësuar frikë primare që ka zgjatur disa 3-5 minuta e shkaktuar nga aksidendi si frikë nga vdekja, dhe frikë sekondare që nënkupton ankthin, shqetësimin aktivitetin shtesë për shk të dëmtimeve të pësuar, prishjen eklimes psikosociale, preokupimin e kontrollave mjekësore, frikën rreth pasojave eventuale. Sipas ekspertës, frika sekondare ka qenë intesitetit të lartë dhe ka zgjatur 78 orë, pastaj me intesitet të mesëm ka zgjatur 2 muja dhe me intesitet të ulët ka zgjatur për më shumë se 6 muaj.

Këto fakte gjykata i vërtetoi nga mendimi i ekspertes mjekësore dr. V.T.eksperte e psikiatrisë dhe i'a fali besimin e plotë, pasi që e njëjta ekspert ka një përvojë të gjatë në këtë lëmi dhe konstatimi i saj ishte punuar në mënyrë profesionale, duke përdorur metodat e parapara për vlerësimin e dëmit, andaj gjykatë vendosi që të caktoj shumat si në dipozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se është në proporcion real me natyrën dhe shkallen e lëndimeve të paditësit.

Konstatimeve të ekspertëve të lartcekur, gjykata u'a fali besimin e plotë, pasi që të njëjtit ekspertë kanë një përvojë të gjatë në këtë lëmi. Konstatimi i tyre ishte punuar në mënyrë profesionale, duke përdorur metodat e parapara për vlerësimin e dëmit.

Për palët ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese baza ligjore e padisë, pra nuk ka qenë kontestuese se me dt.01.09.2020 është shkaktuar aksident trafiku, ku paditësi ka pësuar pa fajin e tij duke pasur lëndime të lehta trupore, poashtu për palët ndërgjyqëse nuk kanë qenë kontestuese ekspertizat mjekësore, por për palën e paditur ka qenë kontestuese lartësia e kërkesëpadisë së paditësit.

I autorizuari i paditësit, kërkesen për kompenzim të dëmit material dhe jomaterial për paditësin, e ka bazuar në ekspertizen mjeksore të datës 24.10.2024, të ekspertëve mjekësor dr. A.F. ortoped – tramatolog dhe dr. V.T.psikatër, mbi te njejtën bazë ka pretenduar se paditësi, ka pësuar lëndime të lehta trupore, ndersa nuk ka qenë kontestuese baza ligjore e padisë.

Vendimi i gjykatës

Gjykata vendosi si në pikën I të këtij aktgjykimi që ta aprovoj pjesërisht kërkesë padinë e paditësit, duke u bazuar në nenet 136.1, 137, të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve si dhe nenit 9 dhe 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia (LSDA-së), edhe atë pasi që sipas ekspertizave mjeko-ligjore, vërtetoi faktin se paditësi B.S., ne aksidentin e trafikut, ka pësuar lëndime të lehta trupore, ka pasur dhembje fizike, kanë pas nevojë për ushqim të përforcuar, siç është vërtetuar edhe sqaruar në gjendjen faktike dhe për këto arsye gjykoj që e paditura të detyrohet që paditësit t'i paguaj shumat e aprovuara, të cilat janë shuma reale dhe sado pak do ti shpërblehet dëmi jo material dhe material i shkaktuar si pasojë e këtij aksidenti, sa i përket lartësisë gjykata u bazua në nenin 323, të LPK-së, pasi që në rastin konkret baza juridike nuk është kontestuese por vetëm lartësia e kërkesëpadisë, e në pamundësi për ta përcaktuar në mënyre të saktë shumat për dëmin jo material, gjyqtari i çështjes vendosi sipas çmuarje së lirë, bazuar në praktikat gjyqësore në raste të ngjashëm dhe duke u bazuar në ekspertizën e ekspertëve mjekësor të ortopedisë dr. A.F. ortoped –tramatolog dhe dr. V.T.psikatër, ku të njëjtit siç shpjegoam në gjendjen faktike si më lartë, kanë vërtetuar se paditësi me rastin e aksidentit i janë shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe dëmtime emocionale e psikologjike.

Prandaj shuma e gjykuara për kompensimin e dëmit jo material si më lartë për paditësin, është më shumë një lloj satisfaksioni moral për paditësin, meqë është e ditur se çfarëdo shume e aprovuar, përsëri nuk do të ishte e mjaftueshme me peshën e lëndimeve dhe dëmtimeve emocionale e psikologjike të pësuar në aksidentin në fjalë për këto arsye kjo gjykatë mendon se shumat e gjykuara (si në pikën I), janë shuma të arsyeshme dhe sadopak do të mund të ndikojnë në zbutjen e dhimbjes së paditësit.

Gjykata me kujdes i analizoi pretendimet e të autorizuarit të paditësit, i cili i propozoj gjykatës që ta miratoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se shumat e kërkuara si në precizim të kërkesëpadisë janë në harmoni me kriteret të cilat aplikohen nga kompanitë e sigurimit dhe praktika gjyqësore, sepse paditësi, ka pësuar lëndime të lehta trupore pa fajin e tij, përgjegjëse për të cilën është e paditura dhe ka obligim të përmbushjes së detyrimeve dhe po ashtu shtoi se kërkesëpadia është në përputhje të plotë me dispozitat e LMD-së dhe se si e tillë duhet të miratohet në tërësi, e këtyre pretendimeve, gjykata pjesërisht ua dha besimin e plotë dhe vendosi si në pikën I në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II, të këtij aktgjykimi, lidhur me kamatën, meqenëse e paditura ka rënë në vonesë për kompensimin e dëmit paditësit, Gjykata në bazë të nenit 382, të LMD-së dhe bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës numër 265/2020 të datës 02.12.2020, bazuar në pjesën e dytë pika VI, ka vendosur që lartësia e kamatës të jetë 8%, ndërsa sa i përketë llogaritjes së saj, nga dita e nxjerrjes së këtij vendimi deri në pagesën definitive, është vendosur po ashtu bazuar po në këtë Mendim Juridik bazuar në Pjesën e Tretë pika XIV.

Gjykata vendosi si në pikën III, të këtij aktgjykimi që ta refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit, të kërkuara përtej shumave të miratuara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, pasi që shumat e kërkuara si në precizimin e kërkesëpadisë ishin shuma tepër të larta, e të cilat nuk përkojnë me asnjë praktikë gjyqësore dhe nuk janë në harmoni me kriteret e kompanive të sigurimit, këtë konkluzion gjykata e bazoi duke marr parasysh llojin e lëndimeve të paditësit, dhimbjet e përjetuara si dhe pasojat tjera të aksidentit, e tërë kjo duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të mjekësisë si

dhe krahasimin e praktikave gjyqësore lidhur me lëndimet dhe pasojat e ngjashme të këtij karakteri, e duke u bazuar në nen 323 të LPK-së, në vlerësimin e lirë ka ardhur në përfundim se shumat e gjykuara në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë shuma reale dhe në përpjesëtim me dëmin e theksuar nga paditësi për shkak të dhimbjeve të përjetuara fizike.

Gjykata e ka refuzuar edhe shumën prej 300 Euro e kërkuar si shpenzim për përkujdesje dhe ndihma e huaj, pasi paditësi me asnjë provë nuk e ka mbështetur ta ketë pasur këtë shpenzim, po ashtu këtë faktë e vërteton edhe eksperti ortoped, i cili në ekspertizën e tij ka theksuar që paditësi nuk ka pasur nevojë për përkujdesje dhe ndihmë nga personi huaj.

Gjykata i analizoi edhe pretendimet e të autorizuarit të paditurës, i cili i propozoj gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj mbi shumën e ofruar edhe në procedurë të rregullt, pasi që shumat e kërkuara si në padi janë shumë të larta dhe se nuk përkojnë as me kriteret e kompanive të sigurimit e as me praktikën gjyqësore në lidhje me lartësinë e kompensimit për raste të tilla apo të ngjashme, këto theksime gjykata pjesërisht i morri si të bazuara e të cilat kishin të bënin lidhur me lartësinë e shumës së kompensimit, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u theksua më lart u vërtetua se paditësi, si pasojë e lëndimeve të shkaktuara në aksidentin e cekur më lart, ka pësuar dëm material dhe jo material, në shumat e caktuara dhe përgjegjësinë për këtë dëm në rastin konkret e mban e paditura, nga baza e auto përgjegjësisë respektivisht në mbështetje të nenit 19 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia (LSDA-së), si dhe duke u bazuar në nenin 136, nenin 173 par.1, 179 dhe nenin 183, të LMD-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për shpenzime të procedurës, gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit duke u bazuar në nenin 452, 453 dhe 463 të LPK-së, shpenzimet e miratuara kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë dhe u kërkuar të specifikuar. Për këtë arsye, e paditura u detyrua që paditësit, t'ia paguaj këto shpenzime të procedurës: 41 Euro për taksën gjyqësore për padi (aq sa paditësi ka paguar sipas UA 2017/1 për Unifikimin e taksave gjyqësore), 104 Euro për përpilim të padisë, për dy seanca të mbajtura secila nga 135 Euro (sipas Rregullores për Tarifa të OAK-së bazuar në vlerën e kontestit nr. tarifar 6 dhe 7), për dy ekspertiza mjekësore secila nga 150 Euro (aq sa paditësi i ka paguar ekspertët), të gjitha në shumë prej 715 Euro. Gjykata nuk e miratoi kërkesën për shpenzime të procedurës në shumë prej 104 Euro, e kërkuar për precizim të padisë, pasi ka vlerësuar se përmbajtja e parashtrësës nuk e arsyeton kërkesën si shpenzim për ndjekje të çështjes, e po ashtu, edhe për faktin se përfaqësuesi i paditësit ka mundur që saktësimin e kërkesave të bëjë në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor

Nga të lartcekurat e duke u bazuar edhe në nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:165747, 18.11.2024
C. nr.617/2021

Gj y q t a r i
Alush Sinani

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:165747
Datë: 25.11.2024
Numri i dokumentit: 06499825